

PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 18.7.2023, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi anëtarja më e vjetër e pranishme e KPF-së. znj. Shqipe Kryeziu.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t’ju përshëndes të gjithëve, Nënkryetarin **Fatmir Iska**, drejtorët e drejtorive. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të KFOR-it, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale në Vrajakë;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Vrajakë;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale në Xërxë;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Xërxë;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt”;
8. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar - qershor 2023;
9. Shqyrtimi i Raportit të ZKA-së, për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit mësimor 2022/2023;
11. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural;
12. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
13. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në komunën e Rahovecit;
14. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit të punës së Zyrës së Prokurimit janar – qershor 2023;
15. Të ndryshme.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara;
Nënkryetari – Faleminderit e nderuar kryesuese e seancës! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë, të gjithë të pranishmit. Është fjala për themelimin e komitetit për persona me aftësi të kufizuara, e keni edhe mënyrën sesi zgjedhet përmes panelit. Më pas shpallet konkursi dhe bëhet përzgjedhja e aplikacioneve.

Kryesuesja – Atëherë, a ka dikush ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Unanimisht kalon edhe pika e gjashtë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt”;

Nënkryetari – Këto memorandume i kemi pasur edhe më herët dhe nëse nuk gaboj para dy viteve unë vet kam qenë nënshkruar i këtij memorandum. Është fjala për “Shtëpinë e Sigurt” ku trajtohen nënat që zakonisht kanë probleme të ndryshme familjare.

Kryesuesja – Atëherë, a ka dikush ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Unanimisht kalon edhe pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar - qershor 2023;

Afrim Limani – Përshëndetje kryesuese, nënkryetar, anëtarë të KPF-së. Raporti 6 mujor financiar kësaj radhe është më voluminoz. Përveç pjesës kryesore të inkasimit të të hyrave dhe pjesës së shpenzimit të buxhetit, në këtë raport janë të inkuorporuar edhe pjesa e obligimeve kontraktuale dhe raporti mbi kontratat e lidhura nga Zyra e Prokurimit. Këtë informata nuk e kemi obligim t’i fusim në këtë raport, por për hirë të transparencës kemi menduar që këto të dhëna të jenë pjesë e raportit. Të hyrat për 6 mujorin e parë për vitin 2023 në total janë 1.029.916€ dhe nëse bëjmë një krahasim me të njëjtën kohë me vitin e kalur, kemi një rezultat pozitiv prej 307.115€. Shpenzimi i buxhetit në total është 53.56%

Kryesuesja – Faleminderit drejtor! Atëherë, a ka dikush ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë kalojmë tutje.

9. Shqyrtimi i Raportit të ZKA-së, për vitin 2022;

Afrim Limani – Auditimi i pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2022 ka rezultuar me raport të pamodifikuar që d.m.th është raport pozitiv. Në vitin 2021 kanë qenë 14 rekomandime, prej të cilave 9 rekomandime janë zbatuar plotësisht, 1 pjesërisht dhe përafërsisht i bie që 10 rekomandime janë të zbatuara. Ndërsa për këtë vit janë 9 rekomandime, 4 prej tyre janë të përsëritura dhe rekomandime të reja i kemi edhe 4 të tjera. Sipas ligjit, komuna jonë e ka të përgatitur planin e zbatimit të rekomandimeve dhe me kohë e ka dërguar në ZKA.

Kryesuesja – Faleminderit drejtor! Atëherë, a ka dikush ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë kalojmë tutje.

10. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit mësimor 2022/2023;

Avni Morina – Faleminderit kryesuese! Të nderuar anëtarë të KPF-së, të gjithë të pranishëm. Në këtë raport janë të pasqyruara të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me arsimin në komunën tonë, prej fillimit të vitit mësimor deri më 30 qershor të këtij viti. Viti shkollor ende nuk ka përfunduar sepse zakonisht përfundon me 31 gusht. Jemi munduar që të pasqyrojmë të gjitha aktivitetet zhvillimet, garat, rezultatet, projektet dhe sfidat që i kemi pasur që në fillim të vitit shkollor, duke përfshirë këtu edhe grevën në arsim, e cila shkaktoi një muaj të plotë mosmbajtje të mësim. Raporti ka gjithsej 6 faqe material.

Kryesuesja – Faleminderit drejtor! Atëherë, a ka dikush ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë kalojmë tutje në pikën e 11-të.

18. Të ndryshme;

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesuese! I nderuar nënkryetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë, zyrtarë komunalë. E kam një propozim, që për shkak të muajit Muharrem, seanca e rregullt e kuvendit të mbahet me datë 31 të këtij muaji.

Kryesuesja – Faleminderit Defrim! E kemi menduar këtë pjesë dhe është vendosur ashtu siç propozove. Me qaq e mbylлим seancën, faleminderit.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

